

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2012

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë*).

DATA	R/REPO njëjavore	R/REPO Ditore	R/REPO njëmujore	R/REPO tremujore
04.10.2012	11,420.00	1,280.00	1,980.00	
05.10.2012		1,280.00		
11.10.2012	15,870.00		2,000.00	
18.10.2012	16,700.00		2,000.00	2,000.00
26.10.2012	16,500.00		3,000.00	
01.11.2012	14,500.00		2,000.00	
08.11.2012	12,500.00		2,000.00	
15.11.2012	14,800.00		2,000.00	
22.11.2012	15,800.00		3,000.00	
23.11.2012		1,850.00		
30.11.2012	14,100.00		1,580.00	
06.12.2012	13,950.00		2,000.00	
13.12.2012	14,130.00		2,000.00	
20.12.2012	11,070.00		2,400.00	
27.12.2012	13,610.00		3,000.00	

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të katërt (T4) të vitit 2012 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim të likuiditetit.

Sasia e likuiditetit të injektuar është stabilizuar rreth nivelit 16 miliardë në T4-2012, kundrejt 17.7 miliardë në T3.

Për injektimin e likuiditetit Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 14.23 miliardë lekë në javë*, shoqëruar njëkohësisht me marrëveshje të anasjelltë të riblerjes me maturim njëmujor, mesatarisht 2.23 miliardë lekë në javë*. Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim tremujor u përdor në vetëm një rast për shumën 2.00 miliardë lekë*.

Shuma e patërhequr ne ankandin rev - repo njëjavor me datë 4 tetor 2012, u injektua me operacione njëditore në datat 4 -5 tetor 2012, të mjaftueshme për mbajtjen e ecurisë së rezervave të tepërta mesatare të sistemit, në linjë me parashikimin. Ndërkohë, në datën 23 nëntor 2012, që përkon me fundin e periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar, me qëllim mbylljen e periudhës me tepëri mesatare pozitive, nevoja për injektim ditor rezultoi 1.85 miliardë leke*.

Në vijim të operacioneve strukturore të tregut të hapur, të zhvilluara në pjesën e parë të vitit, nga të cilat rritja neto e portofolit të BSH-se rezultoi 6.01 miliardë lekë*, gjatë tremujorit të tretë të vitit nisi sterilizimi i këtij efekti me maturimet në tregun primar. Ulja e riinvestimit të portofolit të BSH-së për tremujorin e tretë ishte 1.40 miliardë leke*, ndërkohë që, ashtu siç ishte paralajmëruar, maturimet gjatë tremujorit të fundit të vitit rezultuan 4.61 miliardë lekë*, përqendruar në bono thesari 3 dhe 6 mujore.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë T4- 2012, depozita njëditore u përdor në total në 60 raste, mesatarisht 5.96 miliardë lekë, gati 0.99 miliardë lekë më pak se në tremujorin e kaluar, kur ky instrument është përdorur në 65 raste, duke regjistruar një mesatare për rreth 6.95 miliardë lekë.


* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

Mbi ndërrhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 2 raste, mesatarisht 0.91 miliardë lekë, në datat 23 tetor dhe 21 dhjetor, 2012 që përkojnë me fundin e periudhës së mbajtës së rezervës së detyruar. Gjatë tremujorit të tretë ky instrument u përdor në 5 raste, mesatarisht 1.08 miliardë lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërrhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2011-2012.


Grafik 1: Ndërrhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë viteve 2011-2012 (me çmim blerjeje).



2. NDËRRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË KATËRTTË VITIT 2012

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2012 Banka e Shqipërisë nuk ka qenë e pranishme në tregun valutor.



2.2 Veprime me institucione të tjera

Edhe gjatë këtij tremujori kanë vazhduar të lidhen kontratat *swap* në valutë dhe lekë midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nxitur nga nevoja e menaxhimit të likuiditeteve në valutë të Ministrisë së Financave. Blerjet e valutës së Bankës nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe qenë 4,116.8 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 129.76 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	4,116.8	4,141.3
TË TJERA (IDA, IBRD)	129.76	